



**BASHKIA TIRANË
KËSHILLI BASHKIAK**

V E N D I M

Nr. 71, datë 7.10.2016

PËR

“SHPREHJEN E PËLQIMIT PËR DHËNIEN ME QIRA TË FUSHAVE TË TENISIT PRANË SHKOLLËS 9- VJEÇARE “DORA D’ ISTRIA” ””

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1/1.1, shkronja “b” dhe pika 1/1.2, nenit 25, nenit 54, shkronja “e”, nenit 55, pikat 4 dhe 6 të ligjit nr. 139/2015 për “Vetëqeverisjen Vendore”; Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 143, datë 18.01.2012, për “Miratimin e listës paraprake (pjesa e parë + pjesa e dytë) të pronave të paluajtshme publike, shtetërore që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Tiranë, të Qarkut të Tiranës”; kreut II, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 54, datë 05.02.2014 për “Përcaktimin e kritereve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore” (i ndryshuar); Udhëzimit nr. 6756, datë 03.09.2015 për “Zbatimin e vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 54, datë 5.2.2014 “Për përcaktimin e kritereve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”; Kërkesës me nr. prot. 187, datë 20.06.2016, të Klubit Sportiv “Tirana”, me propozim të Kryetarit të Këshilli Bashkiak:

V E N D O S I:

1. Të japë pëlqimin për dhënien me qira të fushave të tenisit pranë shkollës 9- vjeçare “Dora D’ Istria”, numër pasurie 7/155, me sipërfaqe totale 4403 m² nga e cila sipërfaqe truall 4403 m² dhe sipërfaqe ndërtese 118 m², sipas genplanit bashkëlidhur, me qëllim përdorimin e tyre sipas funksionit që kanë, për një periudhë 20 vjeçare.
2. Ky proces të kryhet nëpërmjet procedurave të konkurimit publik dhe elementëve të tij, në mbështetje të VKM-së nr. 54, datë 05.02.2014 për “Përcaktimin e kritereve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore” (i ndryshuar).
3. Për zbatimin e këtij vendimi, dhe ndjekjen e korresponcencës për kryerjen e procedurave të mëtejshme dhe përcjelljen e dosjes në Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes si përfaqësues i pronarit të pronës publike, ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme Juridike e Aseteve dhe Licensimit.

4. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr.139/2015 për “Vetëqeverisjen vendore” dhe pas konfirmimit ligjor nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Tiranë.

K R Y E T A R

ALDRIN DALIPI